

SHOQERIA "FORALB ALABASTER" SH.P.K
SELIA: KAVAJE, KAVAJE MENGAJ
REGJISTRUAR NE QKB DT. 08.11.1994
NIPT J62903844I

VENDIM NR 2
ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE

Sot më **11.05.2022 ora 11:00** në selinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbahet Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të shoqërisë "FORALB ALABASTER" Sh.p.k. me nipt **J62903844I**. Të pranishëm janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësues i aksionerit shtet, zotërues i 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, përfaqësuar nga Znj. Gjinovefa Arizaj, me autorizim të Ministrit nr. 7429/1, datë 20.04.2022, Znj. Klaudia Gjini, përfaqësues i Aksionerit (pra shoqërisë ALESIO 2014 shpk, me ortak Anton Gjinaj) dhe Administratorit me Prokure Nr.347, Kol 225, datë 06.02.2021 i shoqërisë "FORALB ALABASTER" sh.p.k, Tiranë Kavajë Mengaj dhe aksioner privat, zotërues i 74.99 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Në mbledhjen e datës 11.05.2022, mbështetur në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në mënyrë unanime nga përfaqësuesit e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve prezent:

VENDOSI:

1. Miratimi i pikës 1, të rendit të ditës "Fillimin e procedurës së vlerësimit të paketës së aksioneve në shoqërinë "FORALB ALABASTER" Sh.p.k me qëllim privatizimin".
2. Miratimin e pikës 2 të rendit të ditës "Caktimin e ekspertëve për vlerësimin e paketës së aksioneve". Shoqëria audituese "Euro-Audit, Consultancy.co" shpk dhe ekspertët e vlerësimit të pasurive Z. Dritan Fezga dhe Z.Klajdi Pula, të përgatisin raportin e vlerësimit të aksioneve me vlerat aktuale të tregut dhe t'i referohen pasqyrave financiare të vitit ushtrimor të miratuar në mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve. Raporti i Ekspertëve për përcaktimin e vlerës së paketës së aksioneve dhe dokumentacioni bashkëlidhur të dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Përfaqësuesi i MFE:

Znj. Gjinovefa Arizaj

Përfaqësuesi i Aksioner privat:

Znj. Klaudia Gjini

